

INFORMATOR

RRETH BURSAVE TË SHËRBIMIT TË TRUPIT KOORDINUES I QEVERISË SË REPUBLIKËS SË SERBISË PËR KOMUNAT PRESHEVË, BUJANOC DHE MEDVEGJË

Përmbajtja:

Hyrje	fq. 2
Kushtet për të aplikuar për bursë	fq. 3
Përzgjedhja e kandidatëve	fq. 5
Provimi pranues	fq. 7

HYRJE

Të nderuar studentë të ardhshëm dhe prindër,

Shërbimi i Trupi Koordinues edhe në vitin 2014, ndan bursë për të rinjtë që dëshirojnë të studiojnë në Universitetin e Novi Sadit.

Ky informator përmban informata lidhur me konkursin e Trupit Koordinues për ndarjen e bursave për studentët e ardhshëm. Nëse keni pyetje dhe konsideroni se përgjigjet për ato pyetje nuk janë përfshirë në këtë informator, mund të na shkruani në adresën office@kt.gov.rs, goran.gavrilovic@kt.gov.rs, milutin.jovanovic@kt.gov.rs ose mund të vini në zyrat e Shërbimit të Trupit Koordinues në Bujanoc ose në Preshevë dhe në organin e administratës komunale në komunën e Medvegjës:

Adresa e zyrës së Shërbimit të Trupit Koordinues në Bujanoc: ndërtesa e komunës së Bujanocit Karagjorgje Petroviq 115

Adresa e zyrës së Shërbimit të Trupit Koordinues në Preshevë: Sava Kovaçević 12

Adresa e qendrës të shërbimit të administratës lokale në Medvegjë: rruga Jabllanička 48

1. Kushtet për të aplikuar për bursë

Në vitin 2014, Shërbimi i Trupit Koordinues ndan bursa për të rinjtë që dëshirojnë të studiojnë në ndonjërin nga fakultetet e Universitetit të Novi Sadit .Të gjithë të interesuarit **duhet** të kenë vendbanim në komunat Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë. Bursat ndahen për regjistrim në studime themelore akademike në fakultetet e Universitetit të Novi Sadit.

Për bursë mund të konkurojnë të gjithë ata që i përmbushin këto kritere:

- Të jenë të moshës deri 22 vjeç
- Të kenë vendbanim në territorin e komunave Bujanoc, Preshevë dhe Medvegjë
- Të mos jenë studentë të asnjë fakulteti në territorin e Republikës së Serbisë (duke përfshirë edhe krahinat)
- Gjatë shkollimit të mesëm duhet të kenë arritur **sukses shembullor ose shumë të mirë** dhe të mos kenë përsëritur asnjë vit
- Të flasin gjuhën serbe
- Të mos kenë tjetër bursë në ndonjë konkurs tjetër

Me rastin e konkurimit për bursë të gjithë të interesuarit janë të obliguar që të paraqesin:

- Lutjen me adresë, numrin e telefonit fiks, mobil, email-adresën e kandidatit
- Biografinë
- Letrën motivuese, e cila duhet të përbëhet nga tri pjesë: pjesa e parë e letrës motivuese duhet të përshkruajë qartë arsyet për të cilat kandidati, i cili konkuron për bursë ka vendosur të regjistrojë studimet në fakultetin e caktuar dhe drejtimin përkatës; në pjesën e dytë të letrës motivuese kandidati, i cili konkuron duhet të shkruajë se si planifikon që dituritë e fituara t'i zbatojë në komunën në të cilën jeton; ndërsa në pjesën e tretë të letrës motivuese duhet të shkruhet se në çfarë mënyre dituritë e fituara mund t'i kontribuojnë gjithë bashkësisë dhe zhvillimit të komunës së Bujanocit, Preshevës dhe Medvegjës. Letra motivuese duhet të shkruhet me fontin e shkronjave Times Neë Roman, madhësia e shkronjave 12, largësia në mes të rreshtave 1,0 dhe nuk guxon të jetë më e shkurtër se një faqe. Ata të cilët nuk kanë mundësi ta shtypin letrën motivuese në shtëpi, mund ta bëjnë këtë në zyrat e Shërbimit të Trupit Koordinues në Bujanoc e Preshevë dhe në komunën e Medvgjës.
- Çertifikata e nënshtetësisë (origjinal ose kopja e vërtetuar në gjykatë ose komunë)
- Çertifikata nga libri amëz i të lindurve (origjinal ose kopja e vërtetuar në gjykatë ose komunë)

- Vërtetim për vendbanimin (original ose kopja e vërtetuar në gjykatë ose komunë) ose një kopje të vërtetuar të letërnjoftimit me vendbanim të regjistruar ose të dhënat rreth vendbanimit të deponuara në letërnjoftimin e ri.
- Kopjet të dëftesave për katër vitet e kryera të shkollës së mesme, respektivisht për tre vitet e para dhe gjysmëvjetorin e parë të vitit të katërt (për ata të cilët ende janë në shkollë të mesme)
- Dëshmi për rezultatet e fituara në gara (për ata që kanë marrë pjesë në gara nga cilado lëndë gjatë shkollimit katërvjeçar)

Lutja me dokumentacionin përcjellës dërgohet përmes postës ose personalisht në zyrat e Shërbimit të Trupit Koordinues në Bujanoc dhe Preshevë, dhe në organin e administratës komunale në Medvegjë, **nga 12 Maji deri më 21 Maji të vitit 2014**, në zarfë të mbyllur me titull: **PËR KONKURSIN PËR BURSA STUDENTORE, TË MOS HAPET DERI NË SKADIMIN E AFATIT PËR APLIKIM**

Të gjitha aplikacionet e arritura pas afatit të paraparë nuk do të merren parasysh.

Adresat e zyrave të Shërbimit të Trupit Koordinues në të cilat mund të dërgohet dokumentacioni:

- Zyra e Shërbimit të Trupit Koordinues në Bujanoc, ndërtesa e komunës së Bujanocit, rruga Karagjorgje Petroviq 115
- Zyra e Shërbimit të Trupit Koordinues në Preshevë, rruga Sava Kovaçeviq 12
- Adresa e qendrës të shërbimit të administratës lokale në Medvegjë: rruga Jabllaniçka 48

2. Përzgjedhja e kandidatëve

Procedura për ndarjen e bursave studentore fillon nga marrja e Vendimit të drejtoreshës së Trupit Koordinues rreth shpalljes së konkursit dhe formimit të komisionit. Komisioni procedurën zgjedhore për ndarjen e bursave e zhvillon në dy faza.

- 1) Në fazën e parë të procesit të zgjedhjes, pas kalimit të afatit për paraqitje në konkurs, Komisioni i formuar me Vendimin e drejtoreshës do të formulojë listën për zgjedhjen e kandidatëve për bursë, duke vlerësuar përmbushjen e kushteve formale dhe të cilët do të ftohen në intervistë.
- 2) Në fazën e dytë të procesit të zgjedhjes Komisioni do të ftojë të gjithë kandidatët e paraqitur të cilat i përmbushin kushtet formale. Gjatë intervistës Komisioni do të vlerësoj aftësinë e komunikimit dhe motivimin e kandidatit për studime në fakuletet e Universitetit të Novi Sadit.

Motivimin e kandidatit Komisioni e vlerëson me notat nga 1 deri 3, në këtë mënyrë:

- Nota 3 – motivim i lartë i shprehur
- Nota 2 – motivim mesatar i shprehur
- Nota 1 – motivim jo i mjaftueshëm
-

Aftësitë e komunikimit e kandidatit Komisioni e vlerëson me notat nga 1 deri 3, në këtë mënyrë:

- Nota 3 – aftësi e theksuar komunikuese
- Nota 2 – aftësi mesatare komunikuese
- Nota 1 – aftësi jo e theksuar komunikuese

Çdo anëtar i Komisionit në mënyrë të vetme vlerëson çdo kandidatë sipas dy kriterëve. Vlerësimet e të gjithë anëtarëve të komisionit sipas çdo kriteri mbledhen dhe pastaj llogaritet nota mesatare. Shumën e notës mesatare për dy kriteriumet e jep numrin e përgjithshëm të pikëve për secilin kandidatë. Pas vlerësimit kandidatit sipas dy kriterëve, Komisioni përpilon listën përfundimtare të kandidatëve, të cilën pastaj e shpallë.

Po nëse dy a po më shumë kandidatë kanë numrin e njejtë të poenave, përparsi do të ketë kandidati që ka pasur sukses të shkëlqyeshëm gjat viteve të kaluara të shkollimit. Po nëse edhe në këtë rast kemi numër të njejtë, përparsi do të ketë kandidati i cili e ka notën mesatare më të lartë gjatë viteve të kaluara shkollimit.

Intervista me kandidatët do të mbahet në fund të majit, pas mbarimit të afatit për paraqitje, për të cilën për kohën dhe datën e saktë kandidatët do të njoftohen më kohë.

Vendimin përfundimtar rreth ndarjes së bursave e sjell drejtoresha e Shërbimit të Trupit Koordinues, mbas nënshtrimit të provimit kualifikues për regjistrim në vitin e parë të studimeve dhe atë vetëm për kandidatët të cilët e kanë kaluar provimin pranues në fakultetet e Univerzitetit të Novi Sadit.

Të gjithë kandidatët janë të detyruar që komisionit të Shërbimit të Trupit Koorinues dorëzojnë:

- **Indeksin studentor apo vërtetimin se e ka regjistruar vitin e parë të studimeve themelore në fakultetin e përzgjedhur**

Vendimin përfundimtar për ndarjen e bursave e sjell drejtoresha e Shërbimit të Trupit Koordinues, pas mbarimit të provimit pranues për regjistrim në vitin e parë të studimeve në fakultetet e Universitetit të Novi Sadit, për kandidatët të cilët kanë përbushur kushtet formale ligjore të konkursit. Shërbimi i Trupit Koordinues me bursistët do të lidhë kontratë për bursë për vitin shkollor 2014/2015.

Shërbimi i Trupit Koordinues ndan bursa për studentët, të cilët përbushin të gjitha kriteret e paraqitura në konkurs. Bursat ndahen për periudhën tetor 2014 – qershor 2015. Shuma e bursës mujore është 45.000 dinarë neto dhe jepet për shpenzimet e banimit, ushqimit, transportit dhe shpenzimeve të tjera të jetës studentore, si dhe për blerjen e librave dhe materialeve tjera të nevojshme për të studiuar. Shuma neto e bursës do të paguhet në llogarinë e bursistit në nëntë këste mujore. Të drejtat dhe obligimet do të rregullohen në mënyrë të detajuar me kontratë, e cila lidhet në mes të studentit dhe Shërbimit të Trupit Koordinues. Shërbimi i Trupit Koordinues mban të drejtën që të prishë kontratën për dhënien e bursës studentore në rast se studenti nuk i përbush obligimet nga kontrata, respektivisht nëse nuk i ndjek mësimet dhe ushtrimet, nuk e vërteton semestrin dhe nuk i jep provimet e vitit të parë që nevoiten për të regjistruar vitin e dytë të studimeve. Shërbimi i Trupit Koordinues mban të drejtën që në rast të studimit jo të rregullt të kërkojë nga studenti që t'i kthejë mjetet me kamatë ligjore të mospagimit.

Shërbimi i Trupit Koordinues do të vazhdojë që studentëve të përzgjedhur të ndajë bursa në vitin 2015 me kusht që:

- Që në buxhetin për vitin 2015 të jenë miratuar mjetet për bursa studentore

- Që studenti i përzgjedhur rregullisht t'i ndjekë ligjëratat në Fakultet dhe rregullisht i vërteton semestrat

3. Provimi pranues:

Secili fakultet i Universitetit të Novi Sadit në faqen zyrtare të internetit ka informata të detajuara për:

- Programet studimore të cilat studiohen
- Mënyra e konkurimit në fakultet (dokumentacioni i cili duhet të paraqitet, lartësia e kompensimit që duhet paguar, afati deri kur mund të dorëzohen aplikacionet)
- Regjistrimin në fakultet (cilat dokumente duhet të dërgohen, lartësia e kompensimit për regjistrim, afati kohor deri kur bëhet regjistrimi në fakultet)
- Literatura për përgatitjen e provimit pranues :

Internet prezantimet e fakulteteve:

- 3.1 Fakulteti filozofik: www.ff.uns.ac.rs
- 3.2 Fakulteti i bujqësisë: <http://polj.uns.ac.rs>
- 3.3 Fakulteti i shkencave teknike: www.ftn.uns.ac.rs
- 3.4 Fakulteti i ekonomisë: www.ef.uns.ac.rs
- 3.5 Fakulteti natyroro-matematikor: www.pmf.uns.ac.rs
- 3.6 Fakulteti i teknologjisë: www.tf.uns.ac.rs
- 3.7 Fakulteti i ndërtimtarisë në Suboticë: www.gf.uns.ac.rs
- 3.8 Fakulteti juridik: www.pf.uns.ac.rs
- 3.9 Fakulteti i mjekësisë : www.medical.uns.ac.rs/
- 3.10 Fakulteti i edukatës fizike (DIF) www.fsfvns.rs/
- 3.11. Fakulteti i Akademisë së Arteve www.akademija.uns.ac.rs/